



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	29.08	2022	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRMSTCK	5014/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.618/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.618/2022 të datës 14.07.2022, të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit me numër RAN0004897 të datës 14.06.2022 të Zyrës së Personelit të Komunës së Mitrovicës ,në çështjen juridike “Kontestim Konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.618/2022 e datës 14.07.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër RAN0004897 të datës 14.06.2022 të Zyrës së Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, ndërsa **Anulohet** konkursi i datës 20.05.2022 sipas numrit të referencës RN00008933 për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo Mbledhjes të të Ardhurave, të shpallur nga Komuna e Mitrovicës së Jugut.

III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij.

~~IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.~~

A r s y e t i m

Komuna e Mitrovicës duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 29.04.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 20.05.2022 ka

shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialist të Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo mbledhjes të ardhurave lidhur me pozitën ‘Zyrtar për Tatimin në Pronë’, ndërsa në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja.

Menaxheri i Personelit i Komunës së Mitrovicës me datën 03.06.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër RAN0004897, sipas të cilit ankuesja është njoftuar se nuk është përfshirë në listën e ngushtë, në konkursin për grupin Specialist të Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo Mbledhjes të Ardhurave me arsyetimin se e njëjta nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara të konkursit.

Kundër vendimit për mos përfshirjen në listën e ngushtë të datës 03.06.2022, ankuesja ka parashtruar ankesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës. Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Mitrovicës me datën 14.06.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër RAN0004897 sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë për grupin Specialist të Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo mbledhjes të ardhurave pozita ‘Zyrtar për Tatimin në Pronë’.

Ankuesja kundër Vendimit me numër RAN0004897 të datës 14.06.2022, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Postës së Kosovës me datën 13.07.2022 ka dorëzuar ankesën me numër të protokollit 4105/2022, e cila është pranuar me datën 14.07.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për mos përfshirje në listën e ngushtë nga ana e Njësisë së Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 25.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicë së Jugut, ndërsa kjo e fundit me datë 09.08.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 4617/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. protokollit 4105/2022 të datës 14.07.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje me nr. protokollit 469 e datës 08.07.2022; Konkurs i datës 29.04.2022; Vendim me nr. RAN0004897 i datës 03.06.2022; Ankesë e ankueses drejtuar Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Mitrovicës së Jugut; Vendim me nr. RAN0004897 i datës 14.06.2022; Diplomë e Universitetit ‘Isa Boletini’ e D.I. me nr. 271 e datës 04.06.2021; Letërnjoftim i D.I.; CV-ja e D.I.; Pliko me nr. R2383590 e datës 13.07.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 25.07.2022; Përgjigje në ankesë me nr. protokollit 4617/22 e datës 09.08.2022; Aplikacioni i D.I. i datës 25.05.2022; Vërtetim i D.I. nga Universiteti ‘Isa Boletini’ me nr. 06/192 i datës 18.05.2022; Diplomë e D.I. e datës 02.07.2015; Certifikatë nga IFA për D.I. i datës 16.07.2021; Certifikatë nga IMD për D.J. i datës 20.07.2019; Certifikatë nga Giz për D.J. i datës 09.11.2018; Certifikatë nga IMD për D.J. i datës 18.10.2018; Certifikatë me nr. DA00072 e D.J.; Certifikatë nga Trepça e D.J. e vitit 2017; Certifikatë nga IKD e D.J. e datës 04.05.2018; Certifikatë e Regjistrimit e D.I. e datës 14.10.2020; Referencë për D.I. e datës 23.12.2021; Letër Motivuese nga D.I. e datës 24.05.2022; CV-ja e D.I.; Pliko me nr. R2100332 e datës 05.08.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankueses është e pabazuar, *sepse:*



Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar të gjitha provat e lëndës dhe ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit Specialist të Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo Mbledhjes të të Ardhurave lidhur me pozitën “Zyrtar për Tatimin në Pronë”, kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.*
- *Drejtimi nga fusha ekonomike.*
- *Kualifikime të posaçme formale:*
- *Përvoja e punës e kërkuar. Nuk kërkohet.*

Ndërsa, Kolegji i Këshillit, bazuar në provat e lëndës ka gjetur se ankuesja me rastin e aplikimit për këtë pozitë si dëshmi të përgatitjes së arsimimit të kërkuar ka dërguar: Diplomën me nr. 271 të datës 04.06.2021 sipas së cilës dëshmohet se e njëjta i ka përfunduar studimet në Universitetin “Isa Boletini” Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike dhe ka marr titullin “Bachelor i Shkencave në Inxhinieri Ekonomike”

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së shpalljes së konkursit dhe zhvillimit të procedurave të rekrutimit deri në fazën kur ankuesja ka parashtruar ankesë, ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, konkretisht tek shtojca Nr.2, Kodi i grupit 11. Gr. të kësaj rregulloreje, janë përcaktuar kriteret lidhur me fushën e kërkuar të arsimit për secilën kategori të shërbimit civil, konkretisht për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo Mbledhjes të Ardhurave, fusha e kërkuar e arsimit është ajo në Drejtësi/ Ekonomik (pavarësisht nga specialiteti), ndërsa tek kërkesat e përgjithshme formale sipas kushteve të konkursit i shpallur me datën 20.05.2022 sipas numrit të referencës RN00008933 për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo Mbledhjes të Ardhurave, nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, është përcaktuar vetëm drejtimi nga fusha ekonomike, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se me rastin e ndryshimit të kriterëve të konkursit të datës 20.05.2022 respektivisht mos përfshirja edhe e kriterit “*arsimimit në fushën e Drejtësisë*” siç përcaktohet me dispozitat e kësaj rregulloreje, Komuna e Mitrovicës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.Nr06/L-114 për Zyrtarët Publik neni 6 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: “*Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij-neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive*” si dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores NR. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 4 paragrafi 2 ku përcaktohet se: “*Parimet e pranimit dhe avancimit në karrierë: Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuara në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore*”.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë si dhe analizimit të dispozitave ligjore lidhur me kushtet dhe kriteret e pranimit në shërbimin civil, duke marr për bazë edhe konstatimet e pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se konkursi i shpallur me datën 20.05.2022 sipas numrit të referencës RN00008933 për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo Mbledhjes të të Ardhurave nga Komuna e Mitrovicës është bërë në kundërshtimin me neni 4 paragrafi 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në



kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 Ligjit Nr.Nr06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe mbi këtë bazë ka vendosur të anulojë konkursin e lartë cekur si dhe të shfuqizojë çdo akt tjetër administrativ që rrjedh nga kjo procedurë e rekrutimit, ndërsa ankesa e ankueses është aprovuar mbi bazën e kësaj të gjeture, respektivisht Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar më tej në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, pasi që shpallja e konkursit nuk ka qenë në harmoni me dispozitat akteve ligjore të përcaktuar si më lartë dhe ka vendosur që të njëjtën procedurë të anulojë në tërësi.


Andaj, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.618/2022

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

